



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### ZYRA SHQIPTARE PËR TË DREJTAT E AUTORIT

#### **Aktiviteti i Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit për periudhën Janar-Dhjetor 2012.**

Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit në përmbushje të detyrave të saj të cilat burojnë nga Ligji në fuqi për të drejtën e autorit dhe dokumentat e tjerë strategjikë ka zhvilluar këto aktivitete si më poshtë e ndarë sipas sektorëve:

- ***PROJEKT –LIGJI PËR TË DREJTËN E AUTORIT DHE TË DREJTAT E LIDHURA ME TË.***

Prioriteti kryesor i Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit ka qënë puna me projekt-ligjin e ri, draft ligj në të cilin janë inkorporuar të gjitha komentet dhe sugjerimet e ardhura nga institucionet që merren me zbatimin e ligjit për të drejtën e autorit, ministritë e linjës si dhe nga të gjitha grupet e interesit. Projekt – ligji është dërguar në Ministrinë e Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve për të vijur me pas hapat e tjerë proceduralë drejt miratimit parlamentar të tij. Afati i miratimit të këtij projekt –ligji ka qene dhjetor 2012.

Ndërsa në lidhje me zbatimin e projekt-ligjit të Ri për të drejtën e autorit dhe ndërgjegjësimin e komunitetit të përdoruesve për detyrimet e tyre në bazë të ligjit, për edukimin mbi rëndësinë e IPR, ky është një proces dhe objektiv i cili është parashikuar të arrihet me zbatimin e aktiviteteve afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata.

- **STRATEGJIA KOMBETARE E ZBATIMIT TE TE DREJTAVE TE PRONESISE INTELEKTUALE**

Ka vijuar zbatimi i aktiviteteve te parashikuara dhe te rekomanduara ne SKZPI 2010-2015. Nderkohe gjate muajit maj 2012 eshte mbledhur grupi nderministror i punes i cili me VKM nr 760 date 1 shtator 2012 "Per miratimin e Strategjise Kombetare te Zbatimit te te Drejtave te pronesise Intelektuale" eshte i ngarkuar me monitorimin e planit te punes dhe rezultateve te pritshme nga kjo Strategji.

- **PROJEKTI IPA 2008 "ASISTENCË TEKNIKE PËR FORCIMIN E KAPACITETEVE ZBATUESE TË ZSHDA-S DHE PARTNERËVE TË SAJ"**

Fillimi i vitit 2012 ka qënë i fokusuar në përmbylljen e aktiviteteve të cilat ishin në kuadër të projektit IPA 2008, projekt i financuar nga fondet e BE-së.

Ashtu sic Ju kemi bere me dije Zyra Shqiptare per te Drejtat e Autorit ka qene perftuese ne nje periudhe prej 18 muajsh e nje projekti te Bashkimit European IPA 2008 me Titull "Asistencë teknike për forcimin e kapaciteteve zbatuese të ZSHDA-s dhe partnerëve të saj"

**Institucioni Kryesor përfitues:** Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit

Institucione te tjera përftuese: Agjensitë e Administrimit Kolektiv të të Drejtave të Autorëve dhe të Drejtave të Tjera të lidhura/ Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve/ Drejtoria e Përgjithshme e Doganave/ Këshilli Kombëtar i radios dhe televizionit / Drejtoria e përgjithshme e Policisë/ Gjyqësori/

## **Objektivi i Projektit**

Objektivi dhe qëllimi i projektit është të ndihmohet Qeveria Shqiptare në forcimin e sistemit të të Drejtës së Autorit në përputhje me Standartet Europiane.

Fuqizimi i kapaciteteve të ZSHDA-së dhe partnerëve të saj në vargun e institucioneve me përgjegjësi në zbatimin e ligjit për të drejtën e autorit.

Projekti ka qënë i organizuar në tre komponentë të tij:

- I: Harmonizimi i Legjislacionit
- II: Forcimi i kapaciteteve administrative
- III: Rritje e ndërgjësimit

## **Në 29 shkurt 2012 ka përfunduar projekti I BE IPA 2008 “për forcimin e kapaciteteve zbatuese të ZSHDA dhe partnerëve të saj”.**

Produktet e këtij projekti janë si më poshtë:

- Përgatitja e projekt-ligjit të ri për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e tjera që lidhen me të”
- Vlerësim , sugjerim dhe përgatitje e paketës legislative që duhet të ndryshojë paralalisht me ligjin e ri për të Drejtën e Autorit (KP, KPrP).
- Përgatitja e Planit të Zhvillimit afat-gjatë të ZSHDA-së si dhe të rikonceptimit të funksioneve të saj dhe të misionit të saj për të ardhmen, duke i dhënë të njëjtin model me zyrat homologe të ngjashme në vendet e tjera të EU.
- Trajnime të plota të stafit të ZSHDA-së
- Trajnime të AAK ekzistuese
- Trajnim i gjyqësorit
- Trajnime të ekspertëve të institucioneve zbatuese si Dogana-Polici –Tatime

- Tur seminaresh ndërgjegjësuere në të 12 qarqet e vendit me komunitetin e përdoruesve të pronësisë artistike, letrare e shkencore
- Fushatë publicitare me vendosje të materialeve promocionale e informuese nëpër rrugët e Tiranës, përgatitje fletëpalosjesh, botime nëpër mediat e shkruara dhe prezantime në atë vizive.

### **GJATE KESAJ PERIUDHE 6 MUJORE JANE PERFUNDUAR KETO AKTIVITETE NE KUADER TE IPA 2008**

- Eshte perfunduar raporti i vleresimit te aktivitetit te ZSHDA ne pepruthjet me standartet ISO dhe eshte perpiluar nje raport mbi nivelin e pepruthshmerise se ketyre standarteve me rregulloren e brendsgme dhe me funksionimin e ZSHDA.
- Eshte perfunduar raporti vleresues mbi nevojat e infrastruktures dhe teknologjise se informacionit te ZSHDA ne perputhje me funksionet e reja qe ZSHDA ka te parashikuara me ligjin e ri "Per te Drejtate e Autorit dhe te Drejtat e tjera te lidhura me te".
- Ka perfunduar strategjia e Komunikimit te Zyres Shqiptare per te Drejtat e Autorit
- Ka perfunduar fushata publicitare e parashikuar ne muajin Shkurt me intervista ne mediat e ndryshme kombetare, me vendosjen e city-lighteve promocionale kunder piraterise neper rruget kryesore te qytetit, me hartimin dhe printimin e fletepalosjeve dhe materialeve te reja promocionale te cilat jo vetem ishin si sensibilizim ne luften kunder piraterise, por sherbyen edhe per rritjen e imazhit institucional te ZSHDA.
- Eshte peregatitur raporti statistikor i ZSHDA
- Eshte zhvilluar ne date **15 shkurt** ne ambjentet e hotel "Tirana International" aktiviteti permbylles i projektit ku ishin te pranishem Ambasadori i BE ne Tirane **Z. Ettore Sequi** dhe

Ministri i Ministrise se Turizmit, Kultures, Rinise dhe Sporteve  
**Z. Aldo Bumci.**

Në përfundim të projektit në kuadër të IPA 2008 si dhe me përgatitjen e raportit përfundimtar të tij, u hartuan dhe rekomandime për vazhdimësinë e zhvillimit dhe forcimit të ZSHDA-së dhe të fushës në përgjithësi. Këto rekomandime vijnë edhe pas një njohje të thelluar që ekspertët e projektit patën me realitetin shqiptarë sa i takon zbatimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave që lidhen me të në Shqipëri.

**Rekomandimet kryesore janë si më poshtë:**

1-Miratimi pa vonesë i projekt-ligjit të ri dhe i kuadrit ligjor rregullues për fushën.

2-Trajnime të mëtejshme mbi legjislacionin e ri për: stafin e ZSHDA, AAK, Gjyqësorin si element tejet i rëndësishëm për procesin e zbatimit të këtyre të drejtave, inspektorët e strukturës mbikëqyrëse të tregut për shkeljet në fushën e IP, doganat etj.

3-Fushata të gjera ndergjegjesimi me perdorues te pronesise intelektuale. (gjate zhvillimit te seminareve neper qarqet e Shqiperise u vu re nje nivel shume I ulet I informacionit mbi detyrimet qe burojne nga ligji)

**Te gjitha keto rekomandime do te jene ne fokus te aktivitetit te zyres tone ne vijim.**

➤ **SEKTORI I REGJISTRIM - ÇERTIFIKIM - INPSKETIMIT**

Në Zyrën Shqiptare për të Drejtën e Autorit janë depozituar për regjistrim-çertifikim të objektit të veprimtarisë, kontratave kalim të drejtash dhe e drejtë autori, për **vitin 2012**, gjithsej **181** (njëqind e tetëdhjetë e një) aplikime.

Kanë regjistruar objektin e veprimtarisë **13 (trembëdhjetë)** subjekte që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën botimit, krijimeve kinematografike dhe krijime të tjera audiovizuale, prodhimit, riprodhimit, shpërndarjes dhe dhe përcjelljes në publik të veprave muzikore, si dhe në fushën e transmetimeve dhe ritransmetimeve radio-televizive.

Janë regjistruar dhe çertifikuar **51 (pesëdhjetë e një)** kontrata/autorizime me objekt kalim të drejtash pasurore për veprat letrare, muzikore, kinematografike dhe audiovizuale, kontrata të lidhura ndërmjet autorëve/titullarëve të së drejtës dhe subjekteve, persona fizikë apo juridikë që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e prodhimit, shpërndarjes, shitjes dhe çdo forme tjetër të përcjelljes në publik të veprave objekt kontrate.

Janë regjistruar dhe çertifikuar **105 (njëqind e pesë)** vepra sipas kategorive të përcaktuara në nenin 7 të Ligjit Nr. 9380, datë 28.04.2005, “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, ku më të spikaturat janë në fushën letrare, publicistike, krijime shkencore, projekte, kompozime muzikore, krijime dramatike, kinematografike dhe krijime të tjera audiovizuale.

Janë në proces **12 (dymbëdhjetë)** aplikime të depozituara, të cilat kanë mangësi në dokumentacion dhe aplikuesit janë njoftuar për plotësimin e dokumentacionit, me qëllim procedimin e mëtejshëm në zbatim të Ligjit Nr.9380, datë 28.04.2005, “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”.

Në vitin 2012 ka patur vetëm një kërkesë nga subjektet prodhues për pajisje me Pullën Artistike të Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit. Sqarojmë se për shkak të mospërputhshmërisë së listës së veprave objekt të kontratës së shpërndarjes me kërkesën e subjektit për pajisje me Pulla, subjektit i është kërkuar të depozitojë dokumentacionin e plotë për procedim të mëtejshëm. Në këto kushte kjo praktikë mbetet në proces.

**Përsa i përket monitorimit të tregut nëpërmjet inspektimit dhe marrjen e masave administrative për subjektet që nuk kanë përmbushur detyrimet që burojnë nga Nr.9380, datë**

## **28.04.2005, “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të” gjeni informacionin e detajuar si më poshtë:**

### **1. Inspektive, Konstatime, njoftime;**

Gjatë ushtrimit të kontrollit ndaj subjekteve tregtare, u monitoruan dhe u krye inspektimi në **15** (pesëmbëdhjetë) subjekte tregtare, të cilat tregtojnë pajisje kompjuterike dhe gjatë aktivitetit të tyre posedojnë, shpërndajnë, shesin programe kompjuterike për qëllime fitimi. Subjektet e inspektuara janë monitoruar disa here nga Inspektorët e ZSHDA, ku dhe janë mbajtur proces-verbale përkatëse dhe janë sqaruar në lidhje me detyrimet ligjore që ka çdo subjekt për zbatimin e të drejtës së Autorit.

Nga ri-inspektimi i tyre vihet re se një pjesë e subjektet të kësaj kategorie, kanë reaguar pas informimit të ZSHDA-së, duke blerë programe të licensuara në ushtrim të aktivitetit të tyre tregtar, ndërsa një pjesë tjetër mbajnë në vitrina kompjutera pa sistem operativ ose me free-dos, dhe sistemet operative pa licencë instalohen me shitjen e kompjuterave. **Nga kjo kategori janë gjobitur 8 (tetë) subjekte.**

Janë informuar mbi detyrimet në zbatim të Nenit 130/2 pika (dh) të LDA rreth 50 (pesëdhjetë) për të cilat janë mbajtur proces-verbal informimi, subjekte tregtare që shfytëzojnë programe kompjuterike si Banka, Kompani Sigurimi, Spitale, Call Center, Shoqëri Tregtare etj. Janë bërë me dije të gjithë subjektet e kontaktuar mbi detyrimet që kanë kundrejt titullarëve të së drejtës, për çdo shfrytëzim të veprave, objekt i së drejtës së autorit.

Subjektet përdorues të veprave, objekt i së drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura janë informuar mbi detyrimet që kanë kundrejt agjencive të administrimit kolektiv të licensuara nga Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe që operojnë në mënyrë të ligjshme në territorin shqiptar (**ALBAUTOR, AKDIE, FMAA, AMP**) me qëllim lehtësimin e përmbushjeve të detyrimeve nga subjekte të tilla si: club-e, pub-e, bar- kafe, operatorë radio

televizivë etj.

## **2. Konfiskime:**

Në zbatim të Urdhrit Nr. 1 Prot., datë 10.01.2012, u ngritën grupe të përbashkëta pune ndërmjet Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit (ZSHDA) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT), me objekt punë ushtrimin e kontrollit ndaj subjekteve tatimpagues, përdorues/shfrytëzues të pronësisë artistike, që tregtojnë dhe përcjellin në publik vepra që mbrohen nga e drejta e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me të, nga data 11 janar deri me 31 mars 2012. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Tatimeve, (Task-Force) janë realizuar disa inspektime të përbashkëta në Tiranë, Vlorë, Fier dhe Lushnjë, **ku janë konfiskuar në total 1972 ( një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy) copë CD DVD, pirate.**

## **3. Masa administrative<sup>1</sup>**

Në subjektet ku janë konstatuar kundravajtje administrative janë vendosur masa administrative (gjobë) kundrejt përdoruesve/shpërndarësve të veprave të pronësisë artistike bazuar në **Nenin 131 te Ligjit Nr. 9380 date 28.04.2005 dhe sipas pikes 52 te VKM 232 date 19.04.2006.** Një pjesë e masava administrative kundrejt subjekteve janë bazuar në ankimet e agjencive të administrimit kolektiv “Albautor” dhe “AKDIE”.

### **Konkretisht:**

#### **a) Masa administrative me gjobë, në total 202 përkatësisht:**

**-Bar-kafe  
masa;**

**141**

---

<sup>1</sup> Shënim: Lidhur me masat administrative, të dhenat e mëposhtme përfshijnë dhe masat administrative të vendosura nga Inspektorët e ZRDA, përkatësisht për Qarqet Durrës dhe Elbasan.



<b>-Prodhues, qendra Tregtare &amp; interneti</b>	
<b>Sig-ship</b>	<b>17</b>
<b>masa;</b>	
<b>-vidioteka</b>	<b>12 masa;</b>
<b>-Programe kopjuterike</b>	<b>8masa;</b>
<b>-Kabllor, TV</b>	<b>18 masa;</b>
<b>-Radio</b>	<b>3 masa;</b>
<b>-Hotele</b>	<b>1 masë;</b>
<b>-Botues</b>	<b>2 masa;</b>

#### 4. Inspektimi i subjektit botues **“Belina H”**:

Menjëherë pas marrjes dijani nëpërmjet mediave për botimin në shqip dhe hedhjen në treg të librit të Adolf Hitler “Lufta ime” nga Shtëpia Botuese “Belina H”, Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit inspektoi veprimtarinë e subjektit në përmbushje të detyrimeve ligjore që burojnë nga Ligji Nr.9380, datë 28.04.2005, “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të” dhe konstatoi shkelje të të drejtave të autorit, në botimin e librit në gjuhën shqipe, pa asnjë kontratë me titullarët e së drejtës. Subjekti u ndëshkua me gjobë 100.000 (njëqind mijë) Lekë për botimin e librit me titull: “Lufta Ime” të autorit Adolf Hitler.

#### 5. Inspektimi i subjektit botues **“MIRGEEALB” sh.p.k**:

Bazuar në ankimin e depozituar në ZSHDA nga Z. Jaho Brahaj, autor i veprës me titull: “Flamuri Kombëtar Shqiptar”, regjistruar në ZSHDA me Nr. 66-RDA dt. 12.01.2012, kundër subjektit botues “MIRGEEALB”, ZSHDA ushtroi kompetencat ligjore për kryerjen e inspektimit në këtë subjekt në zbatim të LDA-së.

Nga inspektimi rezultoi se subjekti “MIRGEEALB”, shtëpi botuese dhe shtypshkronjë, kishte botuar veprën me titull “Flamuri

Kombëtar Shqiptar”, pa kontrate botimi me autorin e veprës dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore. Kundrejt këtij subjekti u vendos masë administrative me gjobë, sipas Nenit 130/a të LDA, në vlerën 100.000 (njëqind mijë) Lekë.

Gjithashtu, Sektori Inspektimit, Regjistrim-Çertifikimit ka informuar verbalisht të interesuarit e paraqitur pranë Zyrës, si dhe ka përpiluar shkresa në përgjigje të kërkesave të subjekteve përdorues, titullarëve të së drejtës apo edhe institucioneve shtetërore mbi çështje të lidhura me të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura.

### ➤ **SEKTORI I GJYKIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË ANKIMEVE**

#### **Procedimet administrative:**

Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar **4 (katër) procedime administrative**, nga të cilat:

1 procedim vijon që nga viti 2011 dhe është pezulluar me kërkesë të palës së ankimuar, për shkak të çeljes së një procesi gjyqësor që ka lidhje me objektin e ankimit. (Ankimues subjekti prodhues “Albatrade Plus” dhe palë e ankimuar Radio “Eagle”).

1 procedim është zhvilluar në bazë të kërkesës ankimore të paraqitur në muajin maj, por është zhvilluar vetëm një seancë dëgjimore, për shkak se u tërhoq kërkesa nga pala ankimuese, për t’u vazhduar pranë gjyqësorit. (Ankimues z. Zhani Ziçishti-aktor dhe palë e ankimuar Shoqëria e sigurimeve “Sigal”).

1 procedim është zhvilluar në bazë të kërkesës ankimore të paraqitur në muajin tetor, por është pezulluar për shkak të mungesës së dokumentacionit që provon legjitimitetin e ankimuesit si trashëgimtar ligjor i autorit. (ankimues z. Luan Belegu, trashëgimtar i autorit Xhafer Belegu dhe palë e ankimuar shtëpia botuese “DDS”).

Procesi tjetër administrativ, vijon me thirrjen e palëve në proces. (Ankimues Z. Viktor Papa – autor veprë letrare dhe palë të ankimuar Gazeta “55” si dhe z. Mina Hysa)

Problematika e ndeshur gjatë shqyrtimit të ankesave, është ajo që ka shoqëruar të gjitha procedimet administrative të zhvilluara deri më tani, si:

-Paraqitja e disa kërkesave ankimore të paplota, pra jo në përputhje me përcaktimet e bëra në Kodin e Procedurave Administrative;

-Mosparaqitja e provave që në seancat e para nga pala ankimuese, për të vërtetuar cënimin e së drejtës së autorit/të drejtave të tjera të lidhura me të, e cila sjell zgjatjen e procedimit;

Mosparaqitja në seancë administrative e palës së ankimuar e cila sjell zgjatjen e procesit administrativ.

### **Proceset gjyqësore:**

Spektori i Gjykimit dhe Administrimit të Ankimeve (SGJAA) ka përfaqësuar ZSHDA-në në proceset gjyqësore të mëposhtme:

- **13 (trembëdhjetë) procese** gjyqësore civile pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për cenim të drejtash etj., nga të cilat:
  - Për **6 (gjashtë) procese** është shpallur vendimi i kësaj gjykate.
  - Për **7 (shtatë)** proceset e tjera vazhdon gjykimi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- **4 (katër) procese** gjyqësore civile pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për të cilat është shpallur gjykimi në këtë shkallë.

## **Procese të tjera gjyqësore:**

Pas një korrespondence të gjatë zyrtare me Organet Tatimore dhe Ministrinë e Financave, ku këto institucione shprehen për mosvjeljen e gjobave të vendosura nga Inspektorët e ZSHDA-së (parashikuar në nenin 133 të Ligjit organik LDA) duke referuar për këtë Ligjin Nr.10279 datë 20.05.2010 “Për Kundravajtjet Administrative”, si dhe duke marrë parasysh faktin se këto gjoba kanë kaluar tashmë në Tituj Ekzekutivë që duhen ekzekutuar, gjatë muajit Mars 2012, nga ana e ZSHDA-së u ndërmor një iniciativë për dërgimin e fletë-gjobave të pa vjelura në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për lëshim Urdhër Ekzekutimi.

Nga SGJAA janë ndjekur seancat gjyqësore për lëshim Urdhër Ekzekutimi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për ndjekjen e **64 (gjashtëdhjetë e katër) praktikave**, për të cilat është shpallur vendimi i kësaj gjykate.

- **21 (njëzetëenjë)** kërkesa janë pranuar nga gjykata.
- **43 (dyzetëetë)** kërkesa janë rrëzuar nga gjykata, duke e gjetur të pabazuar ligjërisht kërkesën në Ligjin Nr.10279 datë 20.05.2010 “Për Kundravajtjet Administrative” dhe duke arsytuar se janë organet tatimore ato që janë ngarkuar me vjeljen e gjobave të ZSHDA-së në bazë të nenit 133 të Ligjit organik LDA.

Nga këto vendime për rrëzimin e kërkesës së ZSHDA-së, **18 (tetëmbëdhjetë) prej tyre janë apeluar nga ZSHDA-ja, në shkallë të dytë.**

Afati për apelimin e vendimeve të tjera të rrëzuara është parashkruar, pasi këto vendime nuk janë zbardhur nga gjykata brenda afatit 5 ditor për ankim nga shpallja e vendimit

Vendimet e pranuar nga gjykata për lëshimin e Urdhrit, janë dërguar për ekzekutim pranë përmbaruesve dhe kanë arritur të ekzekutohen 3 gjoba.

### **Shqyrtimi i ankesave të gjobave:**

Gjatë këtij viti pranë SGJAA-së janë paraqitur **14 (katërbëdhjetë) ankimet e mëposhtme** për Fletë-Gjobat e vendosura nga Inspektorët e ZSHDA-së.

- **11 (njëmbëdhjetë) ankime**, të cilat ose janë paraqitur jashtë afatit 10 ditor për ankimet e gjobave (neni 131 i LDA) ose nuk kanë qënë të plota dhe i është kërkuar ankimuesit të bëjë plotësimet sipas nenit 132 të LDA-së. Në kushtet e mosplotësimit të këtyre të fundit sipas ligjit, këto ankesa nuk janë marrë në shqyrtim të mëtejshëm. Në këtë mënyrë, këto 11 gjoba kanë kaluar në tituj ekzekutivë dhe është kërkuar nga ana e ZSHDA-së në gjykatë lëshimi i Urdhrit të Ekzekutimit përkatës.
- Për **3 (tre) ankime** është bërë shqyrtimi i plotë dhe janë përgatitur vendimet përkatëse për refuzimin e ankesës së gjobës. Deri më tani, asnjë prej këtyre vendimeve të ZSHDA-së nuk është ankimuar në gjykatë, pra 3 gjobat kanë kaluar në tituj ekzekutivë. Në këto kushte është kërkuar nga ana e ZSHDA-së në gjykatë lëshimi i Urdhrit të Ekzekutimit.

### **Detyra të tjera:**

Gjatë kësaj periudhe, përgjegjësi i SGJAA:

-Ka përfaqësuar ZSHDA-në në grupin ndër-institucional të kryesuar nga Zv/Ministri i METE-s për hartimin e Raportit vjetor për Politikën Tregtare të RSH në kuadër të raportit vjetor të Organizatës Botërore të Tregëtisë (OBT).

-Ka përfaqësuar ZSHDA-në në grupin ndër-institucional të kryesuar nga Zv/Ministri i METE-s për hartimin e Strategjisë Ekonomike të Vendeve të Europës Juglindore për vitin 2020.

-Gjithashtu, Sektori në tërësi ka përmbushur me efikasitet të plotë edhe punën rutinë administrative të institucionit duke mbajtur korespondencën me subjektet (persona fizikë/juridikë apo agjenci të administrimit kolektiv) si dhe institucionet e ndryshme.

➤ **SEKTORI I MONITORIMIT TË AGJENSIVE TË ADMINISTRIMIT KOLEKTIV PËR TË DREJTAT E AUTORIT DHE TË DREJTAT E LIDHURA**

**1. Kontrolli financiar i të ardhurave të krijuara nga agjencitë ekzistuese të të drejtave të autorit dhe shpërndarjes së tyre tek titullarët e të drejtës të autorit (anëtareve të vet).**

- Shqyrtimi i bilanceve të tre- agjencie më dt. 31/01/2012 reflektoi:
  1. Parregullsi që i janë bërë me dije agjencie “Albautor”, “AKDIE” dhe “FMAA”, nderkohe vetem “FMAA” dhe “AKDIE” janë përgjigjur korespondences sone.
  2. “Albautor” nuk është përgjigjur kërkesës sonë për të rregulluar parregullsite e saj ne lidhje me bilancin e vitit 2011.
- Shqyrtimi i bilanceve më dt. 31/03/2012 reflektoi të njëjtat parregullsi tek agjensitë. Këto parregullsi u janë bërë sërish me dije agjencie përkatëse. Ende sot nuk ka një përgjigje zyrtare nga ana e agjencie “ALBAUTOR” në lidhje me vërejtjet e bëra.
- Agjencitë nuk kanë kryer detyrimin e mbledhjes dhe shpërndarjes së të ardhurave ndaj komunitetit që ata

përfaqësojnë, në emër dhe për llogari të të cilave kanë mbledhur këto të ardhura të deklaruar. Qëllim dhe mision ky që pasqyrohet edhe në ligj.

- E vetmja agjenci që ka bërë shpërndarje për komunitetin që ajo përfaqëson është “FMAA”.
- Vlen për t’u përgëzuar agjencia “AKDIE” dhe “FMAA” për vetëdeklarimin e saktë.

## **2. Kontrolli i kontratave/marrëveshjeve/autorizimeve të lëshuara prej agjencive dhe verifikimi i tyre pranë sektorit të rregjistrimit certifikimit.**

- Agjencia ALBAUTOR nuk i ka dhënë autorizim përdoruesve.
- Nga ana e agjencisë “FMAA” autorizimet janë dhënë në bazë të marrëveshjes me QKK-në.
- Agjencia “AKDIE” ka depozituar te gjitha autorizimet të lëshuara kundrejt subjekteve pranë ZSHDA-së.

## **3. Shqyrtimi i tarifave për përdorimin e veprave letrare, artistike dhe shkencore të paraqitura nga agjencitë e administrimit kolektiv.**

Së fundmi agjencitë kanë deklaruar dhe depozituar pranë Zyrtarëve të Drejtësisë Autorit, tarifën e reja, të miratuara nga Këshilli i Administrimit.

## **4. Gjatë vitit 2012 janë kryer paralelisht me çështjet e sipërpërmendura si vijon:**

- 5.1 Kam hartuar shkresa të cilat kanë pasqyruar përgjigje zyrtare agjencive mbi çështje të ndryshme.
- 5.2 Është kërkuar llogari e vazhdueshme agjencive për të gjitha problemet që kemi hasur.

- 5.3 Kam adminstruar çështjet administrative të ZSHDA-së
- 5.4 Është përgatitur një memo e detajuar për licensimin e Agjencisë “AMP”, pas shqyrtimit të dokumentacionit të saj.
- 5.5 Kam marrë pjesë dhe kam ndjekur ecurinë në rastin kur janë thirrur Asambletë e Përgjithshme të agjencisë “AKDIE” dhe “AMP”, të cilët kanë kryer zgjedhjet e reja dhe kanë zgjedhur Këshillin e ri të Administrimit.
- 5.6 Sektori i Monitorimit ka shtuar presionet për verifikimin e bilanceve të agjencive në detaje dhe për hir të së vërtetës janë vënë re një sërë parregullsish duke filluar me zbardhjen e të gjithë zërave të bilancit dhe pasqyrimin e tyre.

## **5. Nw lidhje me problematiken qw hasin agjensitu.**

1. Procesi i shpërblimit të autorëve nga ana e agjencive është ende i vështirë për t'u arritur plotësisht, pasi të ardhurat e mbledhura nga këto agjensi janë shumë të ulta duke e bërë kështu në shumë raste të pamundur dhe mbulimin e shpenzimeve administrative.

### **Agjencia “Albautor”,**

- Agjencia “Albautor”, rezulton të jetë agjencia më problematike, pasi nuk sjell asnjë informacion mbi kryerjen e aktivitetit të saj dhe për më tepër nuk ka përmbushur detyrimet statutoare duke mos kryer mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme i cili është organ vendimarrës dhe që miraton aktivitetin e kësaj agjencie.
- Kështu, **Neni 27** i Statutit parashikon mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të agjencisë në fund të çdo viti kalendarik (e mërkura e parë e muajit Dhjetor).



- Në vijim, **Neni 29** i Statutit parashikon detyrimin e Asamblesë së Përgjithshme për të shqyrtuar çështjet që përfshihen në objektin e përhershëm të kësaj mbledhjeje. **E pa zhvilluar prej një periudhe 2-vjeçare**
- Agjensitë e administrimit kolektiv të së drejtës së autorit dhe e të drejtave të lidhura me të, janë persona juridikë, që kanë si objekt të veprimtarisë së tyre **mbledhjen e ardhurave për përdorimin e veprave dhe shpërdarjen e tyre të titullarët e të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të**, të cilët ia kanë kaluar këto të drejta për administrim agjencisë.
- Deri në këto momente Albautori nuk ka kryer asnjë shpërndarje të titullarët e të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura

**Në bazë të statutit të agjencisë neni 9 duhet shpërndarja e të ardhurave të titullarët e të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura**

- Agjensitë e administrimit kolektiv të së drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të, janë persona juridikë, që kanë si objekt të veprimtarisë së tyre mbledhjen e ardhurave për përdorimin e veprave dhe shpërdarjen e tyre të titullarët e të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të, të cilët ia kanë kaluar këto të drejta për administrim agjencisë kjo shpërndarje **nuk është kryer akoma, Në bazë të statutit neni 9**
1. Shuma e të ardhurave për vitin 2011 nga veprimtaritë e shfrytëzimit të pasqyruara në pasqyrat financiare nga agjencia **“Albautor”** është **3.720.342** lekë.
  2. Në mënyrë të vazhdueshme kësaj agjencie i është kërkuar informacion i detajuar lidhur me të ardhurat e grumbulluara,

e shoqëruar kjo nga autorizimet përkatëse dhe faturat tatimore shoqëruese të lëshuara nga subjektet përdorues, sërish ky një detyrim ligjor që buron nga ligji, si dhe me bilancin e dorëzuar në ZSHDA, për të dhënë spjegimet përkatëse lidhur me pasqyrat financiare të depozituara.

3. Në bazë të marrëveshjes agjencia duhet të përdorë 25 % të të ardhurave, pra gjithsej për vitin 2011 **shumën prej 930,085 lekë**, ndërkohë që shpenzimet e agjencisë për vitin 2011, (si shpenzime paga e personelit, shpenzime administrative, pagesa telefonash celular, pagesa drita ujë), shpenzime të tjera, janë në shumën prej **2.735.229 lekë**, pra kanë shpenzuar **1,805,144 lekë më tepër**.

#### **Agjencia “AKDIE”**

Agjencia “AKDIE”, rezulton të jetë agjenci problematike,

1. Shuma e të ardhurave për vitin 2011 të pasqyruara në bilancin e agjencisë “AKDIE” janë **3.202.291 lekë**, nga të cilat:
  - të ardhurat e mbledhura nga agjencia nga përdorimi i veprave për vitin 2011 janë në shumën **2.020.030 lekë**,
  - Gjendje në arkë **1.100.408 lekë**.
2. Sipas verifikimeve të bëra në ZSHDA të autorizimeve që agjencia ka lidhur me përdoruesit rezultojnë si më poshtë :
  - Jane pajisur me autorizime dhe faturë TVSH-je 204 subjekte në shumën **3.202.291 lekë**.

Ju risjellim në vëmendje që Agjensitë e administrimit kolektiv të së drejtës së autorit dhe e të drejtave të lidhura me të, janë persona juridikë, që kanë si objekt të veprimtarisë së tyre **mbledhjen e ardhurave për përdorimin e veprave dhe shpërdarjen e tyre të titullarët e të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të**

**lidhura me të**, të cilët ia kanë kaluar këto të drejta për administrim agjencisë.

**Deri në këto momente AKDIE nuk ka kryer asnjë shpërndarje te titullarët e të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura.**

Pavarësisht, Ju duhet të zbatoni dizpozitat ligjore të statutit dhe rregullores së agjencisë.

**Në bazë të statutit të agjencisë neni 19/20/21 duhet shpërndarja e të ardhurave te titullarët e të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura.**

Shpenzimet e agjencisë për vitin 2011 janë në shumën **2.020.030 lekë** të përbëra nga paga dhe sigurime shëndetsore në shumën, amortizime, shpenzime te ndryshme etj.

Agjencia "A.K.D.I.E." duhet të përdorë për shpenzimet e veta 25% të të ardhurave, pra 800,572 lekë, ndërkohë që ka shpenzuar 2.020.030 lekë pra 1,219,458 lekë më shumë.

### **Agjencia “FMAA”**

Agjencia “FMAA”, rezulton të jetë agjencia që ka përmbushur detyrimet në bazë të ligjit

**3.** Shuma e të ardhurave për vitin 2011 të pasqyruara në bilancin e agjencisë F.M.A.A janë **3,504,735 lekë**, nga të cilat:

- të ardhurat e mbledhura nga agjencia nga përdorimi i veprave për vitin 2011 janë në shumën **3.292.153 lekë**,

**2.** Shpenzimet e agjencisë për vitin 2011, shpenzime administrative, (qera e zyrës 12 muaj, pagesa telefonash celular, pagesa drita ujë ) janë në shumën prej **773.169 lekë**.

3. Janë bërë shpërndarje të të ardhurave tek regjisorë/skenaristë anëtare të agjencisë, në bazë **112/d dhe neni 114 pika 2/3/4**, në shumën **2.651.600 lekë**.

### **Agjencia “AMP”**

Agjencia “AMP”, është agjenci e sapo lincensuar dhe nuk ka dorëzuar akoma bilancin e saj të parë pranë Zyrës Shqiptare për të drejtën e Autorit, detyrim ky i parashikuar në ligjin për të drejtën e autorit.

**Në këto kushte, në ushtrim të kompetecave ligjore ZSHDA, bazuar në VKM-në Nr 232,dt 19.04.2006 “Për organizimin dhe funksionimin e ZSHDA” përkatësisht, pika 14, nenit 116 të Ligjit nr. 9380, datë 28.04.2005 "Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Lidhura me të",**

**Propozimin pezullimin e licenës së agjencive “Albautor” dhe “AKDIE” për periudhën 6- mujore, parashikuar në pikën 2 të Nenet 116, si afat i fundit i agjencive për përmbushjen e detyrimeve ligjore**

#### **➤ SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË, PUBLIKUN DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

##### **- Marrëdhëniet ndërkombëtare dhe ato me publikun**

Në kuadër të bashkëpunimit me Organizaten Boterore te Pronesise Intelektuale gjatë vitit 2012 janë zhvilluar keto aktivitetet:

- **24 prill 2012 –Konferenca “5 vjet e Drejta e Autorit në Shqipëri”**. Ky aktivitet u fokusua kryesisht me prezantimin e Ligjit të ri, pasi si ekspert i ftuar I OBPI në këtë aktivitet ishte

edhe hartuesi kryesor I projekt-ligjit të ri, prof. Mihaly Ficsor. Ky aktivitet u mbështetet edhe nga USAID dhe projekti I tij Rritje ALBANIA.

**OBPI** ka kontribuar këtë vit edhe :

- Nje trajnim 2 ditor të gjyqtarëve të Tiranës. Ky trajnim u zhvillua ne date **14-15 qershor 2012** ne Tirane dhe moren pjese mbi 50 gjyqtare.

Ndërkohë nga viti i kaluar vazhdon përgatitja e studimit të mbështetur nga OBPI-mbi **“Impakti ekonomik të industrive të bazuaranë të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të, në ekonominë shqiptare”**.

Në data **15-16 Tetor 2012**, një delegacion i kryesuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Organizatës Botërore të **Pronësisë Intelektuale Z. Francis Gurry** së bashku me **Z. Michal Svantner**, Drejtor i Divizionit për disa shtete të caktuara të Europës dhe Azisë zhvilluan një vizitë zyrtare në Shqipëri **me krerë të lartë të qeverisë shqiptare**.

Z. Gurry Zhvilloi takime me përfaqësuesin më të lartë të ekzekutivit, Kryetaren e Parlamentit, si dhe takim me Drejtorin e ZSHDA, Z. Buëpapaj dhe atë të Drejtorisë së Markave dhe Patentave. Vizita e përfaqësuesit më të lartë të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale Z. Gurry, organizatë, e cila e ka mbështetur ZSHDA-në dhe Shqipërinë me një sërë aktivitetesh të larmishme në fushën e IP, është e para në historinë e vendit tonë.

**Vizitë studimore në Hungari** e zhvilluar gjatë muajit nëntor në Zyrën Shtetërore të Pronësisë Intelektuale ku mori pjesë 1 punonjës i ZSHDA-së. Qëllimi i vizitës ishte përfitimi i eksperiencave më të mira të kësaj zyre në lidhje me funksionimin e Organit të Arbitrazhit dhe të Mediacionit, si dhe njohjen në përgjithësi të funksionimit të kësaj zyre, detyrat e saj, kompetencat. Kjo vizitë u mbështet nga OBPI.

Përsa u takon trajnimeve dhe përmirësimit të kapaciteteve institucionale administrative dhe në këtë periudhe ka vazhduar bashkëpunimi me **Microsoft dhe BSA Albania** në lidhje me trajnimin e inspektorëve të ZSHDA-së përsa i takon identifikimit të programeve kompjuterike genuine.

**20-22 Nëntor 2012**, 2 punonjës të stafit të Zyrës morën pjesë në një Ëorkshop mbi *"Zbatimin e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale"* në Danilovgrad, Mal i zi, organizuar nga **Regional School of Public Administration (RESPA)**, ku ishin të pranishëm Zyra Shtetërore të Pronësisë Intelektuale të Vendeve të Ballkanit Perëndimor.

- **BASHKËPUNIM ME GIZ (PROJEKT I MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME):**

Një plan aktivitetesh është duke u përgatitur për t`u zhvilluar me GIZ në Tiranë, kryesisht sa i takon trajnimin të strukturave zbatuese si dogana, polici, gjykata e inspektoriatit të tregut.

GIZ bashkëpunoi me ZSHDA në organizimin e trajnimit 2 ditor të gjyqtarëve në data 14-15 qershor 2012.

GIZ ka organizuar gjithashtu një vizitë eksperti si dhe ka organizuar një ëorkshop disa ditor me Kryeinspektoren Sllovene sa i takon reformës rregullatore të tregut dhe organizimit të inspektimit të tregut për çështjet e pronësisë intelektuale.

- **BASHKËPUNIM ME OSBE**

Në shkurt të këtij viti në bashkëpunim me Prezencën e OSBE në Tiranë u organizua një takim me median sa i takon cënimit të të drejtave të autorit në fushën e fotografisë.

- **BASHKËPUNIM ME USAID DHE PROJEKTIN RITJE ALBANIA:**

Gjatë këtyre muajve është vendosur një bashkëpunim i ngushtë me USAID nëpërmjet projektit RritjeAlbania, bashkëpunim i cili ka nisur me bashkëfinancimin e tyre në seminarin e datës 24 prill 2012 , ku u bë dhe konsultimi publik i ligjit.

Ky projekt ka treguar një vëmendje të madhe për fushën e pronësisë intelektuale dhe është kthyer në rolin e një ndërmjetësi me të gjithë aktorët e pronësisë intelektuale.

Ata së bashku me Dhomen Amerikane të Tregtisë në muajin maj organizuan një takim me të gjithë aktorët e rëndësishëm të cilët kanë rol në zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Ky takim doli me konkluzionin se do të jetë një sistem monitorues paralel i zhvillimeve të kësaj fushe me qëllim rritjen e vëmendjes së strukturave shtetërore në këtë fushë.

- **BASHKËPUNIMI ME DHOMËN AMERIKANE TË TREGTISË DHE MICROSOFT ALBANIA**

Më datë **5 dhjetor 2012** u zhillua Konferenca Vjetore “Mbrojtja e Pronësisë Intelektuale/ Harmonizimi i legjislacionit shqiptar me atë të BE-së dhe sfidat në të ardhmen”. Ky event u mbështet nga Projekti Rritje Albania, Microsoft etj.

Gjatë aktivitetit u performuan prezantime dhe kazuse të shumta të pronësisë intelektuale në përgjithësi. ZSHDA bëri një prezantim që sjell kuadri ligjor, i cili është çuar tek Ministri për tu aprovuar më pas në parlament. Këtë panel e nderuan me pjesëmarrjen e tyre Ambasadori Amerikan në Tiranë Z. Arvizu dhe Ambasadori i BE-së Z. Sequi, Zv. Ministri i Jashtëm Z. Haxhinasto dhe Z. Bozdo, Zv/Minister i METE.

Të dy ambasadorët theksuan se duhet bërë shumë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të PI, dhe se bizneset amerikane kanë humbje të mëdha sa i takon kësaj fushe për shkak të piraterisë që nuk arrin të kontrollohet nga organet përkatëse rregullatore.

- **PROCESI I INTEGRIMIT**

Gjatë kësaj periudhe është përditësuar Plani Kombëtar i Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Është raportuar në mënyrë periodike sa i takon monitormit të progres raportit të Shqipërisë lidhur me angazhimet që ajo ka në kuadër të antaresimit në BE dhe detyrimeve që rrjedhin nga MSA.

- **MINISTRIA E INTERGRIMIT/ PLOTËSIMI I FORMULARËVE TË TAIEX/KE**

Edhe në fillim të vitit 2012 Zshda ka plotësuar disa formularë tip për Asistencë Teknike të ofruar nga Komisioni Europian nëpërmjet TAIEX/KE. Nuk është konfirmuar asgjë nga MIE, institucioni nëpërmjet të cilit kemi aplikuar. Ndiurma e kërkuar ka qënë kryesisht e fokusuar në ëorkshope apo vizitë eksperti, kjo në kuadër të miratimit të projekt- ligjit të ri për të drejtën e autorit dhe prezantimi tek institucionet zbatuese që merren me zbatimin e ligjit për të drejtën e autorit.

- **BASHKËPUNIMI MË ZYRËN E TË DREJTAVE TË AUTORIT DHE TË DREJTAVE TË PËRAFËRTA NË KOSOVË**

Ka filluar të vendoset një urë bashkëpunimi dhe komunikimi me Zyrën e të Drejtave të Autorit në Kosovë, e cila ndodhet në varësinë e Ministrisë së Kulturës, pas vizitës që një grup nga kjo zyrë vizituan ZSHDA në Shkurt të vitit 2012. Pritet që ky bashkëpunim të forcohet më tej në të ardhmen me organizimin e aktiviteteve të përbashkëta në fushën e PI. Kjo zyrë ka filluar publikimin e një



Reviste Periodike e cila do të botojë here pas here mendime dhe opinione nga stafi i ZSHDA-së.

- **MARRËDHËNIET ME MEDIAN DHE SHTYPIN E SHKRUAR**

Një ndër qëllimet kryesore të ZSHDA, është institucionalizmi dhe ngritja në një nivel të kënaqshëm i prezantimit të aktivitetit të saj në publik. Kjo Zyrë ka detyrim të saj, jo vetëm të realizojë transparencën ndaj publikut, por kryesisht të kryejë një proces sensibilizues, i cili të synojë rritjen e nivelit të njohurive dhe të përgjegjshmërisë, jo vetëm tek strukturat shtetërore zbatuese, të cilat do të lidhen në zinxhir bashkëpunimi me ZSHDA, por dhe ndaj operatorëve ekonomikë, mbajtësve dhe përdoruesve të pronësisë intelektuale (të drejtës së autorit) dhe komunitetit në përgjithësi për krijimin dhe kultivimin e një kulturë sa i takon fushën së të drejtave të autorit.

### **SA I TAKON SEKTORIT TE FINANCES:**

Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit, institucion publik, në varësi të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve ka si objekt të saj mbikqyrjen dhe monitorimin e të drejtave të autorëve dhe të drejtave të tjera të lidhura me të nga subjekte, persona fizike/juridike, privat a publik përdorues të pronësisë letrare, artistike, shkencore.

Për vitin kalendarik 2012 Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit i është miratuar buxheti në shumën prej 16.172.580 lekë, i detajuar si më poshtë:

Fondi i pagave (llog.600) në shumën 12,096,000 lekë,

Fondi për sigurimet shoqërore (llog.601) në shumën 2,010,000 lekë,

Fondi për shpenzimet operative (llog.602) në shumën 1,244,442 lekë,

Fondi për investime (llog.231) në shumën 400,000 lekë.

Për periudhën janar - dhjetor 2012 shpenzimet e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit janë realizuar si më poshtë:

Për pagat e punonjësve janë shpenzuar lekë në shumën prej 11,903,636, pra me një realizim 98.4%

Numri i punonjësve të ZSHDA për vitin 2012 është gjithsej 15 punonjës, të miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr. 105, datë 6.5.2010 "Për disa ndryshime në Urdhërin nr. 166, datë 17.11.2009 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit"

Për sigurimet shoqërore janë shpenzuar lekë në shumën prej 1,918,554, realizuar në përqindje 95.4%

Shpenzimet korente për periudhën janar - dhjetor 2012 janë realizuar në shumën 1,239,848 lekë, realizuar 98.4%

Në zërin investime, (blerje pajisje ), nga 400,000 lekë të miratuara janë shpenzuar 400,000 lekë për blerje pajisje informatike dhe pajisje orendi zyre, pra investimet janë realizuar 100%.

Zyra shqiptare për të Drejtat e Autorit siguron të ardhura nga ofrimi i shërbimeve të specializuara subjekteve të ndryshme, sipas tarifave të miratuara për këto shërbime në VKM nr. 343, datë 06.06.2007 "Për miratimin e tarifave të shërbimeve që ofron Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit", ndryshuar me VKM nr. 461, datë 16.4.2008, por në zbatim të VKM nr. 432, datë 28.06.2007 "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore", pika a, këto të ardhura derdhen tërësisht në buxhetin e shtetit, (të

ardhurat për periudhën janar – nëntor 2012 në shumën prej 268,050, lekë) të detajuara si më si më poshtë:

- nga shërbime të ndryshme 63,150 lekë,
- nga pajisja me pullë artistike 4,900 lekë,
- nga arkëtimimi i gjobave 200,000 lekë